



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datën **16.05.2024, Nr. Regj. Them. 80**, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: shqyrtimin e çështjes penale ndaj të pandehurve: **Julian Preni**, akuzuar për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal; **Arjel Balani** akuzuar për kryerjen e veprave penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 4 i Kodit Penal; **Foti Doda** akuzuar për kryerjen e veprave penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", dhe "*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", të parashikuara nga nenet 245/1 paragrafi 2, 244 të Kodit Penal.
2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga nga gjyqtarët Erjon Çela, Etleva Deda dhe Erjon Bani mbështetur në nenet 35, 59, 244, 245/1 parag. 2 dhe 4 dhe 259 të K.Penal, nenet 190, 403 – 406, 393 dhe 485 të K.Pr.Penal, me vendimin Nr. **40**, datë 26.06.2024 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Julian Preni**, për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e parashikuar nga neni 259 i K.Penal (*para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021*), dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vjet burgim.
2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Julian Preni** me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
3. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Julian Preni** do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal "*Arrest në burg*" dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
4. Në aplikim të nenit 35 të K.Penal heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin **Julian Preni** për një periudhë kohore prej 5 vjetësh.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arjel Balani**, për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” e parashikuar nga neni 245/1, paragrafi katër i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vjet burgim.
6. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Arjel Balani** me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.
7. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Arjel Balani** do të fillojë nga dita që ndaj tij është zbatuar masa e sigurimit personal “*Arrest në burg*” dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
8. Në aplikim të nenit 35 të K.Penal heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për të pandehurin Arjel Balani për një periudhë kohore prej 5 vjetësh.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Foti Doda** për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” e parashikuar nga neni 244 i K.Penal (*para ndryshimeve të pësuarat me ligjin nr. 43/2021*), dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.
10. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Foti Doda** për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” e parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 1 (një) vit burgim.
11. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e dy veprave penale, dënimit e të pandehurit **Foti Doda** me një dënim të vetëm prej 1 (një) viti burgim.
12. Në aplikim 406 të K.Pr.Penale uljen e dënimit me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Foti Doda** me 8 (tetë) muaj burgim.
13. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke e vënë të pandehurin **Foti Doda** në provë për një periudhë kohe prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Zyrën e Shërbimit të Provës ku ka vëndbanimin e tij.
14. Në lidhje me provat materiale të sekuestruara për llogari të këtij procedimi penal, gjykata në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale disponon si më poshtë:
 - Aparat celular i llojit “IPHONE 12 Pro Max”, model A2411, me nr. IMEI 1: *** dhe IMEI ***, i përdorur nga i pandehuri Arjel Balani, ti kthehet të pandehurit konform nenit 190/1 gërma “ç” të K.Pr.Penale, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
 - Aparat celular i llojit “Iphone 13 Pro Max”, model A2643, ngjyrë e bardhë, në gjendje të fikur, me IMEI të stampuar në pjesën e poshtme të kartës ***, i përdorur nga i pandehuri Julian Preni, ti kthehet të pandehurit konform nenit 190/1 gërma “ç” të K.Pr.Penale, pasi vendimi të marrë formë të prerë.

- Aparat celular i llojit “Samsung”, model SM-***, ngjyrë e zezë, në gjendje të fikur, me IMEI 1: *** dhe Imei 2: ***, i përdorur nga shtetasja Sofia Doda, ti kthehet kesaj shtetase konform nenit 190/1 gërma “ç” të K.Pr.Penale, pasi vendimi të marrë formë të prerë.
 - Disk CD-R, me mbishkrimin “Kodak” me shënimin me ngjyrë blu “Fiks Fare, Tetor 2022” me pamjet filmike të emisionit për rastin e shtetasit Foti Doda, copë 1 (një), të qëndrojë në dosje.
 - Disk DVD-R, me mbishkrimin “Sony” me shënimin me ngjyrë të kuqe “Plazhi në Ksamil nga emisioni fiks Fare, datë 18.10.2022”, copë 1 (një), të qëndrojë në dosje.
 - DVD-R, me mbishkrimin “Procedimi penal nr.188/2022 Të dhënat e nxjerra nga ekspertimi, “Akti i ekspertimit nr. 255 datë 13.12.2023”, copë 3 (tre), të qëndrojë në dosje.
 - DVD me mbishkrimin “Name: 188 VITI 2022 DVD_1”, cop 1 (një), të qëndrojë në dosje.
 - Disk CD-R, me mbishkrimin “My media” me shënimin me ngjyrë të zezë “Vendim nr. 1084 2023” dërguar nga Gjykata Sarandë, copë 1 (një), të qëndrojë në dosje.
 - Disk CD-R, me mbishkrimin “Verbatim” me shënimin me ngjyrë të zezë “Fiks Fare Nr 518 Vendimi” dërguar nga Gjykata Sarandë, copë 1 (një), të qëndrojë në dosje.
 - Disk CD-R, me mbishkrimin “Mymedia” me shënimin me ngjyrë të zezë “Vendimi Nr. 518 viti 2023” dërguar nga Gjykata Sarandë, copë 1 (një) të qëndrojë në dosje.
- 15.** Shpenzimet proceduriale të kryera gjatë fazës së hetimit në shumën e përcaktuar në procesverbalin përkatës (33,840.03 leke), të cilat në bazë të nenit 485/1 të K.Pr.Penale janë parapaguar nga shteti, si dhe shpenzimet gjyqësore t’iu ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare, në bazë të neneve 393/1 dhe 406/4 të K.Pr.Penale.
- 16.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datën 26.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar